



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:199213

Datë: 18.10.2021

Numri i dokumentit: 02289557

C.nr. 107/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË, përmes gjyqtarit Haki Gashi, me zyrtaren ligjore Badushe Elezaj në çështjen kontestimore te paditësit A. S. M. nga Prizreni, i përfaqësuar nga av C. G. nga Klina, kunder te paditurit U. H. B. nga fshatiK.Klinë, i përfaqësuar nga Z. B. nga Klina, lidhur me vërtetim pronësie në bazë të ndërrimit,, pas përfundimit te shqyrtimit kryesor në prezencen e paleve ndërgjyqëse, më datën 05.10.2021 muar këtë:

AKTGJYKIM

APROVOHET padia dhe kerkesëpadia e paditësit në tërësi **SI E BAZUAR**

VERTETOHET se paditësi A. S. M. nga Prizreni, me nr personal,, në bazë të ndërrimit është pronarë i paluajtshmërisë dhe atë parcelen nr 713-0 në sipërfaqe prej 2499 m² ZK Gllarevë, e cila evidentohet në emër të H. Rr. B. nga

DETYROHET i padituri U. H. B. nga, që këtë të drejtë të l'a nje paditësit, si dhe të njejtin t'a lejojn në bartjen e të drejtës së pronësisë të patundshmëris në emër të tij, pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Klinë, dhe atë në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këti Aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

OBLIGOHET Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronësi në Klinë që të bëjë bartjen kadastrale të parces dhe atë siç është e precizuara në dispozitiv të këti aktgjykimi.

Arsyetim

Paditësi A. M. nga, përmes të të autorizuarit të tij av C. G., pranë kësaj gjykate kan parashtruar padi kunder te paditurit U. B., trashëgimtar I te ndjerit H. Rr. B., per shkak të vërtetimit te pronësisë në bazë të ndërrimit dhe ka kërkuar nga Gjykata që të obligoj të paditurin që të l'a pranojnë këtë të drejtë ne emër të paditësit dhe atë në ngastren e përcaktuara si në dispozitiv të këti aktgjykimi, dhe i ka propozuar Gjykatës që padia dhe kërkesa e saj të aprovohet ne tërësi si e bazuar.

I autorizuari i të paditurit U. B., trashëgimtar I te ndjerit H. B., me autorizim Z. B. nga, para gjykatës ka deklaruar se nuk e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesën e saj, poashtu nuk ka kundërshtuar raportin gjeodet, pasi që asgjë nuk është kontestuese në këtë çështje dhe mbi një bazë të tillë i ka propozuar gjykatës që padia të aprovohet në tërësi si e bazuar, pasi që në bazë të autorizimit I është dhënë e drejta që të pranoj padinë dhe kërkesën e saj në tërësi.

Gjykatat me datën 15.09.2021 ka bërë daljen në vendin e ngjarjes së bashku me ekspertin e gjeodezisë, ashtu që pas përpilimit të raportit nga eksperti I gjeodezis H. G. ku në këtë rast është vertetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata për vertetimin e gjendjes faktike në bazë të nenit 8 të LPK-së, bëri administrimin e provave si: Raporti gjeodet i datës 21.09.21, aktvdekja e dt 05.10.21, dokumenti nga libri i te vdekurve , për H. B. dt 05.10.21, dokumenti I dt 05.10.21 për të dhënat e Rr. H. B., ekstrakti I gjendjes civile për U. B. dt 05.10.21, çertifikata e pronës draft e dt 04.03.19.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave një nga një, Gjykata erdhi në përfundim se nderimi I paluajtshmërisë në këtë çështje ka ndodhur para shumë viteve , ku një gjë të tillë e pranon edhe i autorizuari i të paditurit dhe asgjë nuk është kontestuese në këtë çështje dhe paditësi është në shfrytëzim dhe posedim të ngastrës të cekur si më lartë I pa penguar nga askush, andaj Gjykata pasi bëri shiqimin e shkresave të lëndës vërtetoi dhe aprovoi padinë e paditësit si të drejtë dhe të bazuar

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv te ketij aktgjykimi e në kuptim të dispozitave te nenit 160 te LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË KLINË, C.nr. 107/19 më dt 05.10.2021.

KËSHILLA JURIDIKE:

Kunder këtij aktgjykimi palët kanë heqë dorë nga e drejta e ushtrimit te ankeses dhe aktgjykimi është i plotfuqishëm ditën e pruarjes së të njejtit, në bazë të nenit 177 të LPK-së.

**Gjyqtari,
Haki Gashi**